



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 19.01.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 17.01.2023, të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Internat Security Association"SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Sigurimi fizik i objekteve të Komunës së Gjakovës ", Nr. i prokurimit- 632-22-6005-2-1-1, Nr. i brendshëm-632-22-052-211, nxjerr:

V E N D I M

- 1. Refuzohet** si e pa bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik "Internat Security Association"SH.P.K, e dt.17.01.2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Sigurimi fizik i objekteve të Komunës së Gjakovës ", Nr. i prokurimit- 632-22-6005-2-1-1, Nr. i brendshëm-632-22-052-211, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të publikuar me datë 13.01.2023, në platformën elektronike të KRPP-së.
- 2. Vërtetohet** NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë 13.01.2023
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "Internat Security Association"SH.P.K., me dt.17.01.2023, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Rrënimi- Sigurimi fizik i objekteve të Komunës së Gjakovës ", Nr. i prokurimit- 632-22-6005-2-1-1, Nr. i brendshëm-632-22-052-211.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 19.01.2023, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pas shqyrtimit të Kërkesës për rishqyrtim të Operatorit Ekonomik "Internat Security Association" SH.P.K., të dt.17.01.2023, Autoriteti kontraktues, sqaron se :

INTERNATIONAL SECURITY ASSOCIATION

151424 orë pune x 2,28€ (1 orë pune) = 345.246,72€

345.246,72€ : 24 muaj = 14.385,28€

14.385,28€ : 38 punëtorë = 378,56€

Paga neto për 1 muaj	280,00€
Tatimi në burim	10,00€
Trusti pensional 5% i punëmarrësit	15,26€
Trusti pensional 5% i punëdhënësit	15,26€
Total pagesa për punëtorë	320,52€
Numri i punëtorëve	38 punëtorë
Muaji	24 muaj
Paga mujore (320,52€ x 38 punëtorë)	12.179,76€
Pagesa për 24 muaj	292.314,24€
TVSH-ja (18%)	52.616,56€
Gjithsej totali	344.930,80€

Nga kjo rezulton se pretendimi juaj është i pabazuar , sepse oferta juaj ka kaluar vlerën e parashikuar.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;

